



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Integritimit Evropian –*  
*Ministarstvo evropskih integracija – Ministry of European Integration*

**Raporti mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e**  
**Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) gjatë vitit 2018**

**Mars 2019**  
**Prishtinë**

## Përmbajtja

<b>0. ZBATIMI I PKZMSA-SË GJATË VITIT 2018: PASQYRË E PËRGJITHSHME</b> .....	<b>5</b>
0.1. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret politike .....	6
0.2. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret ekonomike .....	7
0.3. Gjendja sipas blloqeve: Standardet evropiane – për afrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së .....	8
0.4. Gjendja sipas institucioneve .....	11
<b>1. ZBATIMI I PKZMSA-SË GJATË VITIT 2018 SIPAS KAPITUJVE   BLOKU 1: KRITERET POLITIKE</b> .....	<b>15</b>
<b>1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit</b> .....	<b>15</b>
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor .....	15
1.1.2. Administrata publike .....	15
1.1.3. Avokati i Popullit .....	16
1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë .....	16
<b>1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare</b> .....	<b>17</b>
<b>2. ZBATIMI I PKZMSA-SË GJATË VITIT 2018 SIPAS KAPITUJVE   BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE</b> .....	<b>18</b>
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut .....	18
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit .....	18
<b>3. ZBATIMI I PKZMSA-SË GJATË VITIT 2018 SIPAS KAPITUJVE   BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËR AFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË</b> .....	<b>20</b>
3.0. Korniza ligjore për për afrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së .....	20
3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave .....	20
3.2. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve .....	21
3.3. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve .....	21
3.4. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit .....	22
3.5. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik .....	22
3.6. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive .....	23
3.7. Kapitulli 7 i acquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale .....	23
3.8. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës .....	24
3.9. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare .....	24
3.10. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat .....	25
3.11. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural .....	26
3.12. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë .....	26
3.13. Kapitulli 13 i acquis-së: Peshkataria .....	27
3.14. Kapitulli 14 i acquis-së: Politikat e transportit .....	27
3.15. Kapitulli 15 i acquis-së: Energjia .....	28
3.16. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet .....	29
3.17. Kapitulli 17 i acquis-së: Politikat ekonomike dhe monetare .....	29
3.18. Kapitulli 18 i acquis-së: Statistikat .....	29
3.19. Kapitulli 19 i acquis-së: Politikat sociale dhe punësimi .....	30
3.20. Kapitulli 20 i acquis-së: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë .....	30
3.21. Kapitulli 21 i acquis-së: Rrjetet trans-evropiane .....	31
3.22. Kapitulli 22 i acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore .....	31
3.23. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore .....	31
3.24. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria .....	33
3.25. Kapitulli 25 i acquis-së: Shkenca dhe kërkimet shkencore .....	34
3.26. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura .....	34
3.27. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi .....	35
3.28. Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit .....	36
3.29. Kapitulli 29 i acquis-së: Unioni Doganor .....	36

3.30. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë .....	37
3.31. Kapitulli 31 i acquis-së: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes .....	37
3.32. Kapitulli 32 i acquis-së: Kontrolli financiar .....	37
3.33. Kapitulli 33 i acquis-së: Dispozitat financiare dhe buxhetore .....	38

## HYRJE

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) 2018 – 2022, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (20 shkurt 2018), dhe nga Kuvendi (më 30 maj 2018), është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha institucionet shtetërore. Ato obligohen të zbatojnë masat afatshkurtra në kuadër të kompetencave të tyre, siç janë planifikuar në matricën e këtyre masave, dhe të monitorojnë zbatimin e tyre. Qeveria, si mekanizmi qendror nacional përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, mbikëqyr zbatimin e PKZMSA-së, përmes institucionit që ka mandat koordinimin e procesit të integritimit në BE – Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE). MIE monitoron zbatimin e PKZMSA-së, respektivisht të masave afatshkurtra, në baza tremujore, përmes raporteve të rregullta. Këto raporte shërbejnë për të vlerësuar dhe përmirësuar zbatimin e këtij programi, dhe për llogaridhënie e transparencë brenda institucioneve dhe ndaj palëve të tjera të interesuara dhe publikut të gjerë. Të gjeturat, mes tjerash, diskutohen nga kabineti i Qeverisë dhe nga organet e stabilizim-asociimit BE – Kosovë, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së.

Ky është raporti i katërt dhe i fundit për vitin 2018, dhe mbulon tërë vitin, pra periudhën 1 janar – 31 dhjetor. Të dhënat janë raportuar nga secili institucion përgjegjës përmes *Platformës Online për Monitorim dhe Raportim për Integritim Evropian*, sipas matricës së masave afatshkurtra dhe bazuar në udhëzuesin për këtë qëllim. Në kapitujt ku të dhënat janë raportuar me vonesë ose në mënyrë joadekuate, ato nuk janë përfshirë në raport, dhe masat përkatëse janë vlerësuar si të pazbatuara. Zbatimi i Programit është vlerësuar sipas statusit të ecurisë (ngjyrave të ‘semaforit’, të paraqitura në diagrame), dhe atë si në vijim:

- Masat e përfunduara (ato të cilat janë zbatuar plotësisht) – me **të kaltër**; dhe
- Masat e papërfunduara (ato të cilat nuk kanë arritur të zbatohen plotësisht) – me **të kuqe**.

Ky raport, që përmban katër kapituj, dhe ndahet në dy pjesë: pjesa përmbledhëse dhe ajo sektoriale. Pjesa përmbledhëse (kapitulli I) jep një pasqyrë të përgjithshme mbi zbatimin e Programit gjatë periudhës raportuese. Ajo është e ndarë më tej në katër pjesë: pjesa mbi Programin në tërësi, pjesa për masat legjislativë, pjesa për masat zbatuese, si dhe ajo mbi secilin bllok (Kriteret politike, Kriteret ekonomike dhe Standardet evropiane).

Secili kapitull i raportit përmban diagramin dhe pjesën narrative. Kështu, kapitulli 0 jep një përmbledhje, në diagrame, të gjendjes së zbatimit gjatë periudhës raportuese në katër nivele: Programin në tërësi, sipas kategorive të masave (masat legjislativë dhe ato zbatuese), sipas tri blloqeve, si dhe sipas institucioneve. Pjesa narrative është e ndarë më tej në dy pjesë: përmbledhja e të gjeturave dhe vlerësimi i gjendjes. E para shpjegon përmbajtjen e diagramit. E dyta jep një vlerësim cilësor të gjendjes, ku përmbledhen masat që nuk kanë arritur të zbatohen në kuadër të secilit bllok.


Pjesa tjetër (kapitujt 1, 2 dhe 3) jep një pasqyrë të hollësishme mbi zbatimin e secilit kapitull të Programit gjatë periudhës raportuese. Këta kapituj janë uniformë: secili përmban nga dy pjesë për secilin kapitull të Programit: diagramet dhe pjesën narrative. Diagramet paraqesin të gjeturat mbi nivelin e zbatimit të kapitullit përkatës të Programit. Pjesa narrative shpjegon përmbledhtazi në mënyrë sasore të gjeturat e paraqitura në diagramet përkatës, respektivisht numrin dhe përqindjen e masave të zbatuara dhe atyre të pazbatuara, si dhe një vlerësim i shkurtër cilësor i gjendjes bazuar në nivelin e zbatimit.

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2018 **Programi është zbatuar në nivel prej 68.23%**, pasi që **363 nga 532 masa** të planifikuara janë zbatuar, ndërsa pjesa tjetër prej 169 masave, apo 31.77% e tyre, nuk kanë arritur të zbatohen.

## 0. ZBATIMI I PKZMSA-SË GJATË VITIT 2018: PASQYRË E PËRGJITHSHME

Ky program përmban 532 masa: 144 masa legislative (27.07%) dhe 388 masa zbatuese (72.93%).


Diagrami 0.0.1. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë vitit 2018: zbatimi i të gjitha masave



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *shkalla e zbatimit të Programit gjatë vitit 2018 është 68.23%*, pasi që 363 nga 532 masa të planifikuara janë zbatuar, ndërsa pjesa tjetër prej 169 masave, apo 31.77% e tyre, nuk kanë arritur të zbatohen.

Programi përmban 144 masa legislative.


Diagrami 0.0.2. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë vitit 2018: masat legislative



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *shkalla e zbatimit të Programit gjatë vitit është 55.56%*, pasi që 80 nga 144 masa të planifikuara janë realizuar plotësisht, ndërsa pjesa tjetër prej 64 masave, apo 44.44%, nuk kanë arritur të zbatohen.

Programi përmban 388 masa zbatuese.

Diagrami 0.0.3. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë vitit 2018: masat zbatuese




Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *shkalla e zbatimit të masave zbatuese gjatë vitit 2018 është 72.94%*, pasi që 283 nga 388 masa janë zbatuar, ndërsa pjesa tjetër prej 105 masave, apo 27.06%, nuk kanë arritur të zbatohen.

## 0.1. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret politike

Ky bllok përmban 34 masa: 12 masa legjislativë (35.29%) dhe 22 masa zbatuese (64.71%).

Diagrami 0.1. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Kriteret politike



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *shkalla e zbatimit të këtij blloku gjatë vitit 2018 është 61.76%*, pasi që 21 nga 34 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa pjesa tjetër prej 21 masave, apo 38.24%, nuk kanë arritur të zbatohen.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga institucionet zbatuese për secilin kapitull të këtij blloku, masat kyçe të planifikuara për vitin 2018 të cilat *nuk kanë arritur të zbatohen* janë si në vijim:

- Miratimi i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Miratimi i strategjisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndër-parlamentar, dhe strategjisë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun;
- Miratimi i projektligjit për konfliktet administrative;
- Miratimi i dy akteve nënligjore në fushën e qeverisjes lokale: rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; dhe UA për 'teleprezencën' në Komuna (plotësim-ndryshim);
- Miratimi i dy akteve nënligjore në fushën e bashkëpunimit rajonal: rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institutin e Mjekësisë Ligjore, dhe UA për ekzaminimin mjeko-ligjor;
- Miratimi i dy dokumenteve të politikave: koncept-dokumentit për persona të zhdukur dhe PV për qasje të përbashkët;
- Përditësimi rreth zhvillimit të bazës së të dhënave dhe numrit të shërbimeve që ofrohen nga AP;
- Kryerja e studimit të fizibilitetit të sistemit të vetëqeverisjes lokale;
- Trajnimi i dy (2) antropologëve mjekoligjorë.

## 0.2. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret ekonomike

Ky bllok përmban 14 masa: 4 masa legjislative (28.57%) dhe 10 masa zbatuese (71.42%).

Diagrami 0.2. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Kriteret ekonomike



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *shkalla e zbatimit të këtij blloku gjatë vitit 2018 është 57.14%*, pasi 8 nga 14 masat e planifikuara janë realizuar, ndërsa pjesa tjetër prej 42.86%, apo 6 masa, nuk kanë arritur të zbatohen.

Nga 14 masa, 9 prej tyre, apo 64.28% (3 masa legjislative dhe 6 masa zbatuese), janë planifikuar të zbatohet deri në fund të tremujorit të katërt.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga institucionet zbatuese për secilin kapitull të këtij blloku, masat kyçe të planifikuara për vitin 2018 të cilat *nuk kanë arritur të zbatohen* janë si në vijim:


- Plotësim-ndryshimi i rregullores për menaxherët e lartë në sigurime;
- Rishikimi i Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiar 2019-2023;
- Shfuqizimi i të gjitha tarifave komunale për transferimin e pronësisë që janë në kundërshtim me UA 08/2014 për tarifën për shërbimet e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme;
- Hartimi 25 standardeve të profesionit të cilat verifikohen nga AKK;
- Rishikimi i Kurrikulave të AAP për 20 profile dhe trajnimi i 40 trajnerëve dhe mësimdhënës bazuar në kurrikulën bërthamë.

### 0.3. Gjendja sipas blloqeve: Standardet evropiane – përfrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Ky bllok përmban gjithsej 484 masa: 128 masa legislative (17.23%) dhe 356 masa zbatuese (61.95%).

Diagrami 0.3. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Standardet evropiane

3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE – PËRFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË (masa: 484)



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *shkalla e zbatimit të këtij blloku gjatë vitit 2018 është 69.01%*, pasi që 334 nga 484 masa janë zbatuar, ndërsa pjesa tjetër prej 30.99%, apo 150 masave, nuk kanë arritur të zbatohen.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga institucionet zbatuese për secilin kapitull të këtij blloku, masat kyçe të planifikuara për vitin 2018 të cilat *nuk kanë arritur të zbatohen* janë si në vijim:

- Anëtarësimi i Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës në Byronë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave;
- Adoptimi i 800 Standardeve Evropiane dhe Ndërkombëtare si Standarde Kosovare;
- Miratimi i akteve nënligjore në fushën e të drejtës së themelimit të kompanive dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve: UA për Pronarin Përfitues; UA për strukturën dhe përmbajtjen e raportimeve financiare vjetore;
- Koncept Dokumentit për Ligjin për Konkurrencën nr. 03/L-229 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-226;
- Miratimi i Planit të Veprimit për Politikën e Konkurrencës dhe konsultimi me aktorët relevant;
- Rekrutimi i Shtatë (7) zyrtarëve në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës;
- Përfundimi i strukturës organizative e KIESA-s duke marrë në konsideratë fushëveprimin e përgjegjësive të KIESA, dhe rekrutimin e punonjësve të kualifikuar;
- Miratimi i tri manualeve në fushën e shërbimeve financiare: për likuiditetin bankar; për mbikëqyrjen i bazuar në rrezik (Sigurimet); dhe për mbikëqyrjen on-site të pensioneve;
- Zhvillimi dhe funksionalizimi i Softuerit të Menaxhimit të rrezikut dhe Biznesi i Inteligjencës;
- Finalizimi i kornizës për zgjedhjen alternative të bankave që përfshin ristrukturimin e kostos ekonomikisht të favorshme;
- Miratimi i katër akteve nënligjore në fushën e shoqërisë së informacionit dhe mediave: UA për kushtet që duhet t'i plotësojnë ofruesit e shërbimeve të tregtisë elektronike; rregullores për pronësi të mediave dhe parandalim të koncentrimit të mediave; rregullores për krijimin e fondit për stimulim të programeve; dhe rregullores për të drejtën për shteg dhe shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës (plotësim-ndryshim);
- Miratimi i Strategjisë për Digjitalizim të Transmetimit Tokësor;
- Anëtarësimi i KOS-CERT në FIRST;
- Miratimi i katër projektligjeve në fushën bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe atë të sigurisë së ushqimit: për bujqësi dhe zhvillim rural; për ushqimin; për veterinarinë; për farëra; dhe për materialin fidanor;
- Miratimi i Programit vjetor 2019 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;



- Rekrutimi i 20 zyrtarëve në kuadër të AZhB (nga projekti i BB);
- Konsolidimi i 2,370 ha e tokës bujqësore në shtatë (7) zona kadastrale në komunën e Vitisë;
- Miratimi i rregullores mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre, të cilat nuk janë të destinuara për konsum njerëzor; dhe i planit shumëvjeçar për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve;
- Miratimi i projektligjit mbi transportin rrugor;
- Miratimi i dy akteve nënligjore në fushën e transportit: UA për rregullat dhe mënyrën e organizimit të provimit për certifikatën e kualifikimit profesional (CKP); rregullores që përcakton kërkesat e përdorimit të përbashkët të hapësirës ajrore dhe procedurat operative për shmangien e përplasjeve në ajër; dhe rregullores lidhur me miratimin specifik të operimeve të avionëve me një motor me turbinë gjatë natës ose në kushtet meteorologjike me instrumente dhe kërkesat për miratimin e trajnimeve për mallrat e rrezikshme për operacionet e specializuara komerciale, operimet jo-komerciale të avionëve kompleks me motor dhe operimet e specializuara jo-komerciale të avionëve kompleks me motor;
- Miratimi i strategjisë së sektorit të aviacionit civil;
- Trajnimi i pesë (5) inspektorëve (për kontrollet në rrugë për mallra të rrezikshme);
- Zbatimi në praktikë në fushën e transportit: funksionalizimi i bazës së të dhënave për gjendjen e auto-udhëve; zbatimi i fazës së parë e rehabilitimit të segmenteve prioritare të linjës hekurudhore 10 (segmenti Fushë Kosovë – Hani i Elezit, kredi nga BEI); përfundimi i pesë vendkalimeve hekurudhore; dhe testimi i kandidatëve në mënyrë elektronike;
- Zbatimi në praktikë në fushën e statistikave: publikimi i tabelave ofruese-përdoruese (*supply and use tables-SUT*) për vitin referues 2014; publikimi i anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC); dhe publikimi i anketës e kostos së punës;
- Zhvillimi dhe funksionalizimi i Softuerit të Menaxhimit të Rrezikut dhe Biznesi i Inteligjencës;
- Miratimi i dy projektligjeve në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore: projekt-kodit të procedurës penale; dhe projektligjit për RTK-në;
- Miratimi i akteve nënligjore në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore: rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e KGJK-së (plotësim-ndryshim); rregullores për organizimin e brendshëm në gjykata (plotësim-ndryshim); rregullores për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit (plotësim-ndryshim); rregullores për transferimin dhe avancimin e prokurorëve (plotësim-ndryshim); rregullores për punës së Komisionit Disiplinor dhe procedurën disiplinore ndaj prokurorëve (plotësim-ndryshim); aktit nënligjor që rregullon zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; UA që përcakton kushtet dhe procedurat e veçanta për dhënien e lejes për të dënuarit që punojnë jashtë institucionit korrektues, dhe procedurat për punën e të dënuarve jashtë institucionit korrektues; dhe UA për mbrojtjen e fëmijëve në internet; dhe rregullores për përkrahjen e projekteve për komunitete;
- Miratimi i dokumenteve të politikave në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore: Planit Strategjik të Sistemit Prokurorial 2019 - 2021; Strategjisë dhe PV për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (2018-2022); Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2018-2022; Strategjisë për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; Strategjisë dhe PV për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2022; Strategjisë për Komunitete dhe Kthim; Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve; Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (2017-2020); Koncept-dokumentit për inicimin dhe themelimin e byrosë shtetërore për përkthime;
- Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore: përzgjedhja e tre (3) anëtarëve/eve të Këshilli Prokurorial të Kosovës; rekrutimi i nëntë (9) prokurorëve të rinj; transferimi i tetë (8) prokurorëve në PSRK; rekrutimi i tridhjetë e dy (32) gjyqtarëve në të gjitha gjykatat; emërimi i zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi në nivelin lokal; emërimi i komisionerit dhe anëtarëve të Bordit të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; krijimi i bazës së të dhënave për personat e zhvendosur; funksionalizimi i Programit për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të lëndëve, i funksionalizuar;

- Zbatimi në praktikë në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore: funksionalizimi i regjistrit të centralizuar të evidencës penale; licencimi i noterëve; realizimi i 37 inspektimeve për noterë dhe 38 inspektimeve për përmbarues privatë; shqiptimi i gjobave ndaj subjekteve politike lidhur me mospublikimin e raportit të shpenzimeve vjetore dhe të fushatës zgjedhore; hartimi i raporteve të monitorimi për zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit; publikimi i Indeksit të Barazisë Gjinore 2018; themelimi i qendrës diagnostikuese për klasifikimin e personave të burgosur; zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor nga institucionet; zbatimi i 35 vendimeve të pazbatuara për rrënimin e strukturave ilegale të ndërtuara në prona private; mbyllja e 5 qendrave kolektive në komunën e Shtërpcës; kryerja e inspektimeve të rregullta dhe atyre të bazuara në ankesa mbi zbatimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale; Krijimi i mekanizmave për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve me dhunti të veçanta/inteligjencë të jashtëzakonshme dhe talente në fusha akademike;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për drejtësi, liri dhe siguri: marrëveshjes me Malin e Zi për ekstradim; Marrëveshjes me Malin e Zi për ekzekutim të ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në çështjet penale; marrëveshjes me Malin e Zi për ndihmë juridike të ndërsjellë në çështjet penale; dhe marrëveshjes me Italinë për transferim të personave të dënuar mes dy vendeve;
- Miratimi i akteve nënligjore në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë: UA për procedurën standarde të pritjes dhe trajtimit fillestar të azilkërkesve (plotësim-ndryshim); UA për procedurat dhe standardet e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit lidhur me kërkesën për azil (plotësim-ndryshim); UA për procedurën e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt dhe vërtetimit për lajmërimin e punës (plotësim-ndryshim); rregullores për integrimin e të huajve; UA për kthimin e të huajve; rregullores së punës dhe e procedurave të Autoritetit Qeveritar për Migrim;
- Miratimi i dokumenteve të politikave në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë: strategjisë së re shtetërore dhe PV për MIK 2019-2024; planit të reagimit për menaxhimin e fluksit të mundshëm me migrantë; Strategjisë së re shtetërore dhe PV për migrim 2019-2024; planeve komunale të riintegritimit; Strategjisë për policinë e udhëhequr nga intelijenca; strategjisë shtetërore dhe PV kundër krimit të organizuar 2018 – 2023;
- Ngritja kapaciteteve institucionale në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë: katër (4) trajnime të specializuara për identifikimin e dokumenteve të falsifikuara (për 30 zyrtarë); avancimi i pajisjeve në fushën e teknologjisë informative; dhe ndërtimi i stacionit policor për togjet patrulluese kufitare në Vitomiricë; funksionalizimi i pikës së kalimit kufitar në Kapi; fillimi i ndërtimit të pikë-kalimit të përbashkët për kontroll kufitar në Bernjak dhe Stanqiq-Bellanoc; ndërtimi i pikë-kalimeve të përbashkëta të kontrollit kufitar në Merdare dhe Mutivodë;
- Zbatimi në praktikë për drejtësi, liri dhe siguri: kryerja e inspektimeve në konsullata; ofrimi i tri (3) trajnimeve mbi pranimin, identifikimin dhe profilizimin e azilkërkesve, sidomos të atyre pa dokumente identifikimi;
- Miratimi i akteve nënligjore në fushën e arsimit: UA për kushtet dhe kriteret që drejton themelimin e formave duale të arsimit dhe aftësimin profesional, në të cilën aftësimi paraprak dhe përvoja realizohen në ndërmarrje; UA për etapat e parapara për fitimin e të drejtës në Ushtimin e Profesionit të Rregulluar (akt nënligjor i ri); UA për organizimin dhe funksionimin e organit profesional për zhvillimin e standardeve të profesionit; UA për rregullat për funksionimin e Komisionit të Provimit Shtetëror, kompensimin e anëtarëve të saj, si dhe procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të provimit shtetëror;
- Zbatimi në praktikë në fushën e arsimit: zhvillimi i kurrikulës për edukim parashkollor (mosha 0-5 vjeç) në 7 institucione parashkollore; ndërtimi i tetë (8) institucioneve parashkollore publike;
- Miratimi i tri projektligjeve në fushën e mjedisit: për mbeturinat nga industria e nxjerrjes së mineraleve; për gjuetinë; dhe për pyjet e Kosovës;
- Miratimi i dy akteve nënligjore në fushën e mjedisit (plotësim-ndryshim): UA për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes; dhe UA për eksport, import dhe transit të mbeturinave;

- Miratimi i tetë (8) dokumenteve të politikave në fushën e mjedisit: strategjisë për menaxhimin e Mbeturinave 2018-2028; PV për menaxhimin e mbeturinave 2018 - 2020; strategjisë dhe PV për ndryshime klimatike; programit nacional për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura 2018-2025; dhe katër (4) planeve rregulluese të hollësishme për zonat e treta të mbrojtura të parqeve kombëtare;
- Hartimi i Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME-ve) sipas Planit të Reagimit Kombëtar;
- Miratimi i dy ligjeve (plotësim-ndryshim) dhe një akti nënligjor në fushën e shëndetësisë: projektligjit për shëndetësi; projektligjit për sigurime shëndetësore; dhe UA për rregullimin e çmimit të produkteve dhe pajisjeve medicinale;
- Miratimi i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (plotësim-ndryshim);
- Miratimi i një projektligji dhe dy dokumenteve të politikave në fushën e politikës së jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes: projektligjit për sanksione ndërkombëtare; strategjisë për politikën e jashtme; dhe strategjisë kombëtare të sigurisë.


#### 0.4. Gjendja sipas institucioneve

Kjo shtojcë jep një pasqyrë të gjendjes së zbatimit të Programit gjatë vitit 2018 sipas institucioneve, me qëllim të vlerësimit të performancës së secilit prej tyre në zbatimin e masave nën përgjegjësinë e tij. Kështu, institucionet janë *ranguar* sipas *përqindjes së masave të zbatuara*, nga ai me *performancën më të mirë* deri te ai me *performancën më të dobët*.

Sa i përket performancës së *institucioneve të Qeverisë* në zbatimin e masave nën përgjegjësinë e tyre *gjatë vitit 2018*, të gjeturat tregojnë si në vijim:

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) - 100% (10/10 masa të zbatuara);
2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) - 100% (5/5 masa të zbatuara);
3. Ministria e Integritimit Evropian (MIE) - 90.91% (10/11 masa të zbatuara);
4. Ministria e Financave (MF) - 84% (28/33 masa të zbatuara);
5. Ministria e Administratës Publike (MAP) - 80% (8/10 masa të zbatuara).
6. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) - 75% (9/12 masa të zbatuara);
7. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) - 73% (57/78 masa të zbatuara);
8. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) - 73% (19/26 masa të zbatuara);
9. Ministria e Drejtësisë (MD) - 65.79% (25/38 masa të zbatuara);
10. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) - 61.90% (13/21 masa të zbatuara);
11. Ministria e Infrastrukturës (MI) - 61.11% (11/18 masa të zbatuara);
12. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) - 55.56% (5/9 masa të zbatuara);
13. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) - 52% (12/23 masa të zbatuara);
14. Zyra e Kryeministrit (ZKM) - 50% (12/24 masa të zbatuara);
15. Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) - 50% (2/4 masa të zbatuara);
16. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT) - 42.11% (8/19 masa të zbatuara);
17. Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit (MKK) - 33.33% (2/6 masa të zbatuara); dhe
18. Ministria e Shëndetësisë (MSh) - 14.29% (2/14 masa të zbatuara).


Diagrami 0.4.1. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Gjendja sipas institucioneve – institucionet e Qeverisë



Në anën tjetër, sa i përket performancës së *institucioneve të tjera* në zbatimin e masave nën përgjegjësinë e tyre *gjatë vitit 2018*, të gjeturat tregojnë si në vijim:

1. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) - 100% (7/7 masa të zbatuara);
2. Akademia e Drejtësisë (AD) - 100% (6/6 masa të zbatuara);
3. Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) - 100% (6/6 masa të zbatuara);
4. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) - 100% (3/3 masa të zbatuara);
5. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRrPP) - 100% (2/2 masa të zbatuara)
6. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OShP) - 100% (2/2 masa të zbatuara);
7. Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) - 100% (1/1 masë e zbatuar);
8. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) - 81.82% (9/11 masa të zbatuara);
9. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) - 81.25% (26/32 masa të zbatuara);
10. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKKK) - 80% (4/5 masa të zbatuara);
11. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) - 75% (6/8 masa të zbatuara);
12. Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) - 75% (6/8 masa të zbatuara);
13. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) - 73.68% (14/19 masa të zbatuara);
14. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) - 66.67% (4/6 masa të zbatuara);
15. Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) - 66.67% (2/3 masa të zbatuara);
16. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - 66.67% (2/3 masa të zbatuara);
17. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) - 61.54% (8/13 masa të zbatuara);
18. Kuvendi i Republikës së Kosovës (Kuvendi) - 61.54% (8/13 masa të zbatuara);
19. Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore (AKMRSB) - 60% (3 / 5 masa të zbatuara);
20. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) - 57.14% (4/7 masa të zbatuara);
21. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) - 50% (1 / 2 masë e zbatuar);
22. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) - 50% (1/2 masë e zbatuar);
23. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AShMDhP) - 0% (0/3 masa të zbatuara);
24. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) - 0% (0/3 masa të zbatuar);
25. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës (Infrakos) - 0% (0/1 masa të zbatuara).

Diagrami 0.4.2. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Gjendja sipas institucioneve – institucionet e tjera



# 1. ZBATIMI I PKZMSA-SË GJATË VITIT 2018 SIPAS KAPITUJVE | BLOKU 1: KRITERET POLITIKE

## 1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

### 1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor

Ky kapitull përmban 6 masa: 1 është masë legislative (16.66%) dhe 5 masa zbatuese (83.33%).

Diagrami 1.1.1. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 50%**, pasi që **3 nga 6 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 50% e tyre (3 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:


- Miratimi i rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Miratimi i dy dokumenteve të politikave: strategjisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërparlamentar; dhe strategjisë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun.

Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në grafikun më sipër, **olen të theksohet që të gjitha masat e planifikuara pothuajse janë realizuar sipas planifikimit, edhe pse dy nga masat kyçe janë miratuar në janar të vitit 2019. Pra, dy strategjitë e lartcekura janë miratuar me 18 janar 2019 dhe nëse merret parasysh kjo vonesë e vogël në miratim, atëherë shkalla e zbatimit për këtë fushë do të dilte rreth 84%. Megjithatë, edhe pse Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës është miratuar në lexim të parë me 30 mars 2018 dhe tashmë ka kaluar në fazën e shqyrtimit në komisionet e përhershme, kjo rregullore nuk ka arritur të miratohet gjatë vitit 2018. Si rrjedhojë, ka kaluar për miratim në vitin 2019.**

### 1.1.2. Administrata publike

Ky kapitull përmban 18 masa: 8 masa legislative (44.44%) dhe 10 masa zbatuese (55.55%).

Diagrami 1.1.2: Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Administrata publike



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 72.2%**, pasi që **13 nga 18 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 27.8% e tyre (5 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:

- Miratimi i projektligjit për konfliktet administrative; dhe dy akteve nënligjore:
  - rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; dhe
  - UA të plotësuar-ndryshuar për teleprezencën e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informative, “Teleprezencave”;
- Përditësimi rreth zhvillimit të bazës së të dhënave dhe numrit të shërbimeve që ofrohen nga AP; dhe
- Kryerja e studimit të fizibilitetit të sistemit të vetëqeverisjes lokale.

Bazuar në të gjeturat e raportit, ky sektor përgjithësisht ka pasur zhvillime më të mëdha gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018. Pra, me miratimin e Pakos Ligjore për RAP në Qeveri (dhe më fillim të vitit 2019 edhe në Kuvend) kjo fushë ka arritur të shënojë rritje të madhe në zbatim të masave të planifikuara për vitin 2018, sidomos masave kyçe që definojnë këtë sektor. Tani veçse është filluar me hartimin e legjislacionit sekondar në fushën e administratës publike. Megjithatë, është hasur në vonesa në zbatimin e disa masave të cilat planifikohen të zbatohen në fillim të vitit 2019. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet Ligjit për Konflike Administrative si dhe rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

### 1.1.3. Avokati i Popullit

Ky kapitull përmban 5 masa zbatuese.

Diagrami 1.1.3. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Avokati i Popullit



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 100%**, pasi që **të gjitha masat** janë zbatuar.

### 1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë


Ky kapitull nuk përmban masa afatshkurtra.



## 1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare

Ky kapitull përmban 5 masa: 3 masa legislative (60%) dhe 2 masa zbatuese (40%).

Diagrami 1.2. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 0%*, pasi që asnjë nga masat e planifikuara nuk ka arritur të zbatohet.

Masat të cilat *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:

- Miratimi i dy akteve nënligjore:
  - Rregullorja për organizim të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe
  - UA për ekzaminimin mjeko-ligjor;
- Miratimi i dy dokumenteve të politikave:
  - Koncept-dokumenti për persona të zhdukur; dhe
  - PV për Qasje të Përbashkët; dhe
- Trajnim i dy (2) antropologëve mjekoligjorë.

*Si rrjedhojë e të gjeturave të raportit, ky sektor përgjithësisht ka vonesa serioze në zbatimin e masave të planifikuara për realizim. Vonesa po ashtu janë paraqitur në lidhje me trajnimin e antropologëve mjekoligjorë. Për më shumë, duhet të theksohet se ky kapitull përgjithësisht ka vonesa serioze në miratimin e rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Institutin e Mjekësisë Ligjore, miratimin e UA për ekzaminimin mjeko-ligjor dhe në miratimin e Planit të veprimit për Qasje të Përbashkët. Masat e pazbatuara janë rishikuar dhe bartur për zbatim gjatë vitit 2019.*

## 2. ZBATIMI I PKZMSA-SË GJATË VITIT 2018 SIPAS KAPITUJVE | BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE

### 2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Ky kapitull përmban 9 masa: 3 masa legislative (33.33%) dhe 6 masa zbatuese (66.67%).

Diagrami 2.1. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 77.78%**, pasi që **7 nga 9 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 22.22% e tyre (2 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:

- Plotësim-ndryshimi i rregullores për menaxherët e lartë në sigurime; dhe
- Rishikimi i Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023;

Nisur edhe nga të gjeturat e raportit, ky sektor përgjithësisht ka nivel të kënaqshëm të zbatimit gjatë vitit 2018. Dy masa nuk kanë arritur të zbatohen gjatë vitit 2018: plotësim-ndryshimi i rregullores për menaxherët e lartë në sigurime dhe rishikimi i strategjisë për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizimit dhe krimeve financiare 2019-2023.

### 2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit

Ky kapitull përmban 5 masa: 1 masë legislative (20%) dhe 4 masa zbatuese (80%).

Diagrami 2.2. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 20%**, pasi që **1 nga 5 masat** e planifikuara janë zbatuar plotësisht, ndërsa 80% e tyre (4 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:

- Shfuqizimi i të gjitha tarifave komunale për transferimin e pronësisë që janë në kundërshtim me UA 08/2014 për tarifën për shërbimet e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme;
- Nisja e procedurës së likuidimit për së paku 40 Ndërmarrje Shoqërore;
- Hartimi njëzetepesë (25) standardeve të profesionit të cilat verifikohen nga AKK; dhe
- Rishikimi i Kurrikulave të AAP për 20 profile dhe trajnimi i 40 trajnerëve dhe mësimdhënës bazuar në kurrikulën bërthamë.


*Ky sektor përgjithësisht nuk ka nivel të kënaqshëm të zbatueshmërisë të masave të planifikuara. Gjatë vitit 2018 nuk kanë arritur të zbatohen masat si shfuqizimi i gjitha tarifave komunale për transferimin e pronësisë që janë në kundërshtim me UA 08/2014 për tarifën për shërbimet e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, procedura e likuidimit e nisur për së paku 40 Ndërmarrje Shoqërore gjatë vitit 2018, hartimin e njëzetepesë (25) standarde të profesionit të cilat verifikohen nga AKK, si dhe në kurrikulat të AAP për 20 profile të rishikuara dhe 40 trajnerë dhe mësimdhënës të trajnuar bazuar në kurrikulën bërthamë.*

3. ZBATIMI I PKZMSA-SË GJATË VITIT 2018 SIPAS KAPITUJVE | BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJSLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË

3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Ky kapitull përmban 6 masa zbatuese.

Diagrami 3.0. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecuresisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 83.33%*, pasi që *5 nga 6 masat* e planifikuara janë zbatuar plotësisht, ndërsa 16.67% e tyre (1 masë) nuk kanë arritur të zbatohen.


Masa e cila *nuk ka arritur të zbatohet* është hartimi i manualit për rishikimin e akteve ligjore të përkthyer.

*Pilot-projekti për rishikimin e akteve ligjore të përkthyer në gjuhën shqipe është planifikuar të startojë së zbatuari në mars 2019. Kane përfunduar me sukses përgatitjet për lansimin zyrtar të punëtorisë me Ministrinë e lënë ku edhe do të simulohet profesionalisht me rishikim të akteve të zgjedhura për përkthim dhe rishikim ligjor. Theksojmë se pas përfundimit të pilot projektit, rekomandimet e dala do të shërbejnë si manual për procesin në fjalë.*

3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave

Ky kapitull përmban 8 masa: 2 masa legjislative (25%) dhe 6 masa zbatuese (75%).

Diagrami 3.1. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Lëvizja e lirë e mallrave



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecuresisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 75%*, pasi që *6 nga 8 masat* e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 25% e tyre (2 masa zbatuese) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:

- Anëtarësimi i Agjencisë së Metrologjisë në Byronë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave; dhe

- Adoptimi i 800 Standardeve Evropiane dhe Ndërkombëtare si Standarde Kosovare.

Ky sektor përgjithësisht ka shënuar progres të kënaqshëm në realizimin e masave. Megjithatë, vonesa e probleme serioze kemi sa i përket anëtarësimit të Agjencisë së Metrologjisë në Byronë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIPM) dhe adoptimin e numrit të synuar të Standarde Evropiane dhe Ndërkombëtare si standarde Kosovare.

### 3.2. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve

Ky kapitull përmban 2 masa zbatuese.

Diagrami 3.2. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Liria e lëvizjes së punonjësve




Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 100%*, pasi që 2 nga 2 masat e planifikuara janë zbatuar plotësisht.

Ky sektor ka nivel shumë të kënaqshëm pasi që të gjitha masat e planifikuara gjatë vitit 2018 janë zbatuar.

### 3.3. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Ky kapitull përmban 8 masa: 5 masa legislative (62.50%) dhe 3 masa zbatuese (37.50%).

Diagrami 3.3. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 62.50%*, pasi që 5 nga 8 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 37.50% e tyre (3 masa legislative) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që nuk kanë arritur të zbatohen janë:

- Miratimi i tri akteve nënligjore:
  - UA për etapat e parapara për fitimin e të drejtës në Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar;
  - UA për rregullat për funksionimin e Komisionit të Provimit Shtetëror, kompensimin e anëtarëve të saj, dhe procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të provimit shtetëror; dhe

- o UA për organizimin dhe funksionimin e organit profesional për zhvillimin e standardeve të profesionit.

Ky sektor përgjithësisht ka shënuar progres të kënaqshëm në realizimin e masave. Vonesa kemi sa i përket miratimit të UA që zbatojnë Ligjin për Profesione të Rregulluar.

### 3.4. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit

Ky kapitull përmban 3 masa: 2 masa legislative (66.67%) dhe 1 masë zbatuese (33.33%).

Diagrami 3.4. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Lëvizja e lirë e kapitalit



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 66.67%**, pasi që 2 nga 3 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 33.33% e tyre (1 masë) nuk kanë arritur të zbatohen.


Masa që **nuk ka arritur të zbatohet** është miratimi i UA për Pronarin Përfitues.

Ky sektor përgjithësisht ka nivel të kënaqshëm të zbatimit të masave të planifikuara. Masa e cila nuk ka arritur të zbatohet paraqitet në miratimin e UA për Pronarin Përfitues.

### 3.5. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik

Ky kapitull përmban 6 masa: 2 masa legislative (33.33%) dhe 4 masa zbatuese (66.67%).

Diagrami 3.5. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Prokurimi publik



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 100%**, pasi që 6 nga 6 masat e planifikuara janë zbatuar.

Masat e planifikuara në këtë sektor janë zbatuar në tërësi.

### 3.6. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive

Ky kapitull përmban 3 masa: 2 masa legislative (66.66%) janë masa legislative, ndërsa 1 prej tyre (33.37%) janë masa zbatuese.

Diagrami 3.6. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: E drejta e kompanive



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecuresë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 66.67%*, pasi që 2 nga 3 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 33.33% e tyre (1 masë) nuk kanë arritur të zbatohen.


Masa që nuk ka arritur të zbatohet është plotësim-ndryshimi i UA për strukturën dhe përmbajtjen e raportimeve financiare vjetore.

Ky sektor përgjithësisht ka realizim të kënaqshëm. Masa e cila nuk ka arritur të realizohet paraqiten në miratimin e UA për strukturën dhe përmbajtjen e raportimeve financiare vjetore.

### 3.7. Kapitulli 7 i acquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale

Ky kapitull përmban 6 masa: 3 masa legislative (50%) dhe 3 masa zbatuese (50%).

Diagrami 3.7. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: E drejta e pronësisë intelektuale



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecuresë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 100%*, pasi që 6 nga 6 masat e planifikuara janë zbatuar plotësisht.

Ky sektor ka nivel shumë të kënaqshëm pasi që të gjitha masat e planifikuara gjatë vitit 2018 janë zbatuar.

### 3.8. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës

Ky kapitull përban 9 masa: 3 masa legislative (37.5%) dhe 6 masa zbatuese (62.5%).

Diagrami 3.8. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Politikat e konkurrencës



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 66.67%*, pasi që **6 nga 9 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 33.33% e tyre (3 masa zbatuese) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:


- Miratimi i
  - Koncept-dokumentit për Ligjin për Konkurrencën nr. 03/L-229 (plotësuar-ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-226); dhe
  - PV për Politikën e Konkurrencës (konsultuar me akterët relevantë); dhe
- Rekrutimi i shtatë (7) zyrtarëve në AKK.

*Ky sektor përgjithësisht ka shënuar progres të kënaqshëm në realizimin e masave. Nuk janë realizuar 3 masat e listuara më lartë. Sa i përket rekrutimit të Shtatë (7) zyrtarëve, janë rekrutuar 4 (katër) zyrtarë (inspektorë të tregut) në periudhat e më hershme (K2), ndërsa 3 (tri) pozita të tjera mbetet të rekrutohen në fillim të vitit 2019.*

### 3.9. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare

Ky kapitull përban 11 masa: 6 masa legislative (54.54%) dhe 5 masa zbatuese (45.46%).

Diagrami 3.9. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Shërbimet financiare



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 63.64%*, pasi që **7 nga 11 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 36.36% e tyre (4 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat të cilat **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:

- Miratimi i tri manualeve:
  - Likuiditet bankar;




- Mbikëqyrjen i bazuar ne rrezik (sigurimet); dhe
- Mbikëqyrjen on-site të pensioneve;
- Finalizimi i kornizës për zgjedhjen alternative të bankave që përfshinë ristrukturimin e kostos ekonomikisht të favorshme.

Ky sektor përgjithësisht ka zbatim relativisht të kënaqshëm, sidoqoftë ka masa që nuk kanë arritur të zbatohen gjatë vitit 2018 që janë listuar më lartë.

### 3.10. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat

Ky kapitull përmban 18 masa: 9 masa legislative (50%) dhe 9 masa zbatuese (50%).

Diagrami 3.10. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Shoqëria e informacionit dhe mediat



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 66.67%*, pasi që **12 nga 18 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa **33.33% e tyre** (6 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:

- Miratimi i dy akteve nënligjore:
  - UA për kushtet që duhet ti plotësojnë ofruesit e shërbimeve të tregtisë elektronike; dhe
  - Rregullores për pronësi të mediave dhe parandalim të koncentrimit të mediave; dhe
- Miratimi i Strategjisë për Digjitalizim të Transmetimit Tokësor;
- Anëtarësimi i KOS-CERT në FIRST.

Bazuar në të dhënat e ofruara më lart, rezulton se zbatimi i masave në kuadër të këtij kapitulli është në nivelin e kënaqshëm. Mirëpo, pavarësisht realizimit të një numri të madh të masave ligjore dhe zbatuese, disa nga masat kyçe të planifikuara për këtë kapitull, përkatësisht aktet ligjore dhe nënligjore si dhe nga korniza e politikave të cilat ndikojnë në reformimin e politikave të sektorit të shoqërisë informative dhe mediave, kanë dështuar të miratohen sipas afateve të parapara dhe, për më tepër, disa masa përcillen si të porealizuara nga viti paraprak siç është rasti i Strategjisë për Digjitalizim të Transmetimit Tokësor.

### 3.11. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Ky kapitull përmban 15 masa: 1 masë legislative (6.67%) dhe 14 masa zbatuese (93.33%).

Diagrami 3.11. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Bujqësia dhe zhvillimi rural



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 73.33%*, pasi që *11 nga 15 masat* e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 26.67% e tyre (4 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:

- Miratimi i projektligjit për bujqësi dhe zhvillim rural;
- Miratimi i programit vjetor 2019 për bujqësi dhe zhvillim rural 2019;
- Rekrutimi i 20 zyrtarëve në kuadër të AZhB; dhe
- Konsolidimi i 2,370 ha e tokës bujqësore në shtatë (7) zona kadastrale të komunës së Vitisë.

Bazuar në të dhënat e ofruara më lart, rezulton se zbatimi i masave në kuadër të këtij kapitulli është në nivelin e kënaqshëm. Mirëpo, pavarësisht realizimit të një numri të madh të masave ligjore dhe zbatuese, disa nga masat kyçe të planifikuara për këtë kapitull, përkatësisht miratimi i Ligjit dhe programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, të cilat ndikojnë në reformimin e politikave të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, kanë dështuar të miratohen dhe realizohen sipas afateve të parapara.

### 3.12. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë

Ky kapitull përmban 13 masa: 6 masa legislative (46.15%) dhe 7 masa zbatuese (53.85%).

Diagrami 3.12. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Politikat e sigurisë së ushqimit, veterinarisë dhe fitosanitarisë



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 53.85%*, pasi që *7 nga 13 masat* e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 46.15% e tyre (6 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:

- Miratimi i katër (4) projektligjeve:
  - Ligji për ushqimin;
  - Ligji për veterinarinë;
  - Ligji për farëra; dhe
  - Ligji për materialin fidanor;
- Miratimi i rregullores mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre të cilat nuk janë të destinuara për konsum njerëzor; dhe
- Miratimi i planit shumëvjeçar për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve.

Bazuar në të dhënat rezulton se zbatimi i masave në kuadër të këtij kapitulli nuk është i kënaqshëm. Janë realizuar masat zbatuese, por masat kyçe të planifikuara për këtë kapitull, pra aktet ligjore dhe nënligjore të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në reformimin e politikave në këtë kapitull, veterinarisë dhe fitosanitarisë, kanë dështuar të miratohen sipas afateve të parapara dhe, për më tepër, janë masa të cilat përcillen si të përealizuara nga viti në vit.


### 3.13. Kapitulli 13 i acquis-së: Peshkataria

Ky kapitull nuk përmban masa.

### 3.14. Kapitulli 14 i acquis-së: Politikat e transportit

Ky kapitull përmban 36 masa: 18 masa legjislative (50%) dhe 18 masa zbatuese (50%).

Grafiku 3.14. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Politikat e transportit



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 72.22%*, pasi që *26 nga 36 masat* e planifikuara janë zbatuar, ndërsa *27.78% e tyre* (10 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:


- Miratimi i ligjit mbi transportin rrugor; dhe dy akteve nënligjore:
  - UA për rregullat dhe mënyrën e organizimit të provimit për certifikatën e kualifikimit profesional (CKP); dhe
  - Rregullores lidhur me miratimin specifik të operimeve të avionëve me një motor me turbinë gjatë natës ose në kushtet meteorologjike me instrumente dhe kërkesat për miratimin e trajnimeve për mallrat e rrezikshme për operacionet e specializuara komerciale, operimet jo-komerciale të avionëve kompleks me motor dhe operimet e specializuara jo-komerciale të avionëve kompleks me motor;
- Miratimi i strategjisë së sektorit të aviacionit civil;
- Funkcionalizimi i bazës së të dhënave për gjendjen e auto-udhëve;
- Zbatimi i fazës së parë e rehabilitimit të segmenteve prioritare të linjës hekurudhore 10 (segmenti Fushë Kosovë - Hani i Elezit, kredi nga BEI).

Bazuar në të dhënat e ofruara më lart, rezulton se zbatimi i masave në kuadër të këtij kapitulli është në nivelin e kënaqshëm. Mirëpo, pavarësisht realizimit të një numri të madh të masave ligjore dhe zbatuese, disa nga masat kyçe të planifikuara për këtë kapitull, përkatësisht aktet ligjore si Ligji mbi transportin rrugor dhe nga masat zbatuese si Funksionalizimi i bazës së të dhënave për gjendjen e auto-udhëve, të cilat ndikojnë në reformimin e politikave të sektorit të transportit, kanë dështuar të miratohen dhe realizohen sipas afateve të parapara.

### 3.15. Kapitulli 15 i acquis-së: Energjia

Ky kapitull përmban 18 masa: 9 masa legislative (50%) dhe 9 masa zbatuese (50%).

Diagrami 3.15. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Energjia



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 50%*, pasi që **9 nga 18 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 50% e tyre (9 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat të cilat **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:


- Miratimi i dy projektligjeve:
  - Ligji për tregti me naftë produkte të naftës e karburante të ripërtëritshme në Kosovë; dhe
  - Ligji për rezervat e obligueshme të naftës;
- UA për përdorimin e bio-karburanteve dhe bio-lëngjeve;
- Miratimi i dy dokumenteve të politikave:
  - Strategjisë dhe PV për mbrojtje nga rrezatimi dhe për siguri bërthamore; dhe
  - PV i rishikuar për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Mbyllja financiare e Projektit TC Kosova e Re (Shpallja për projektim, inxhinierim dhe ndërtim, dhe sigurimi i kredive për projektin, si dhe pesë (5) studime për projektin);
- Studimi për vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social si dhe plani i çmontimit për dekomisionim;
- Certifikimi i Operatorit të sistemit të transmisionit.

Bazuar në të dhënat e ofruara më lart, rezulton se zbatimi i masave në kuadër të këtij kapitulli nuk është në nivelin e kënaqshëm. Pavarësisht realizimit të një numri të madh të masave ligjore dhe zbatuese, disa nga masat kyçe të planifikuara për këtë kapitull, përkatësisht aktet ligjore dhe nënligjore si dhe nga korniza e politikave të cilat ndikojnë në reformimin e politikave të sektorit të energjisë, kanë dështuar të miratohen dhe realizohen sipas afateve të parapara. Për më tepër, disa nga këto masa përcillen si të parealizuara nga viti paraprak siç është rasti i studimit për vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social si dhe plani i çmontimit për dekomisionim, ligji për tregti me naftë produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë si dhe Ligji për rezervat e obligueshme të naftës.

### 3.16. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet

Ky kapitull përmban 7 masa zbatuese.

Diagrami 3.16 Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Tatimet



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 85.71%*, pasi që 6 nga 7 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 14.29% e tyre (1 masë zbatuese) nuk kanë arritur të zbatohet.

Masa që *nuk ka arritur të zbatohet* është zhvillimi dhe funksionalizimi i Softuerit të Menaxhimit të rrezikut dhe Biznesi i Inteligjencës

Ky sektor përgjithësisht ka nivel të kënaqshëm të ecurisë për zbatimin e masave të planifikuara. Vonesa ka pasur në zhvillimin dhe funksionalizimin e Softuerit të Menaxhimit të rrezikut dhe Biznesi i Inteligjencës. Për këtë softuer është bërë hapja e fazës së dytë për aktivitetin e prokurimit: "Modernizimi i Sistemit të Teknologjisë Informativë". Komisioni vlerësues ka vlerësuar dosjet e dorëzuara nga 2 operatorë.


### 3.17. Kapitulli 17 i acquis-së: Politikat ekonomike dhe monetare

Ky kapitull nuk përmban masa.

### 3.18. Kapitulli 18 i acquis-së: Statistikat

Ky kapitull përmban 8 masa: 1 masë legislative 1 (12.5%) dhe 7 masa zbatuese (87.5%).

Diagrami 3.18. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Statistikat



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 62.50%*, pasi që 5 nga 8 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 37.50% e tyre (3 masa zbatuese) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:

- Publikimi i tabelave ofruese-përdoruese (*supply and use tables-SUT*) për vitin referues 2014;

- Publikimi i Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC);
- Publikimi i Anketës e kostos së punës.

Ky sektor përgjithësisht ka nivel të kënaqshëm të zbatimit me disa vonesa për disa masa të listuara më sipër. Sa i përket publikimit të anketës së kostos së punës, ky aktivitet pritet të përfundohet gjatë vitit 2019-2020. Sa i përket SILC-ut, është realizuar në terren në muajin Maj-Korrik 2018 dhe raporti pritet të publikohet në pjesën e dytë të vitit 2019 (të dhënat ne EUROSTAT dërgohen ne muajin nëntor 2019).

### 3.19. Kapitulli 19 i acquis-së: Politikat sociale dhe punësimi

Ky kapitull përmban 3 masa: 2 masa legislative (66.66%) dhe 1 masë zbatuese (33.33%).

Diagrami 3.19. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Politikat sociale dhe punësimi




Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 100%**, pasi që të 3 masat e planifikuara janë zbatuar.

Ky sektor ka nivel të kënaqshëm pasi që të gjitha masat e planifikuara gjatë vitit 2018 janë zbatuar.

### 3.20. Kapitulli 20 i acquis-së: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë

Ky kapitull përmban 2 masa zbatuese.

Diagrami 3.20. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 50%**, pasi që 1 nga 2 masat e planifikuara është zbatuar plotësisht, ndërsa 50% e tyre (1 masë) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masa që nuk ka arritur të zbatohet është përfundimi i strukturës organizative e KIESA-s duke marr në konsideratë fushëveprimin e përgjegjësive të KIESA, dhe rekrutimin e punonjësve të kualifikuar.

Ky sektor përgjithësisht nuk ka arritur të arrijë nivel zbatimi përtej gjysmës së masave të planifikuara.

### 3.21. Kapitulli 21 i acquis-së: Rrjetet trans-evropiane

Ky kapitull nuk përmban masa.

### 3.22. Kapitulli 22 i acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Ky kapitull përmban 7 masa: 2 masa legislative (28.58%) dhe 5 masa zbatuese (71.42%).

Diagrami 3.22. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 100%*, pasi që *të gjitha (7) masat* e planifikuara janë zbatuar.

### 3.23. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Ky kapitull përmban 123 masa: 19 masa legislative (15.45%) dhe 104 masa zbatuese (84.55%).

Diagrami 3.23. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Gjyqësori dhe të drejtat themelore



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 67.48%*, pasi që *83 nga 123 masat* e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 35.52% e tyre (40 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat kyçe që *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:

- Miratimi i dy projektligjeve:
  - Projekt-kodit të procedurës penale; dhe
  - Projektligjit për RTK-në;
- Miratimi i akteve nënligjore:
  - Rregullore për sistematizimin e vendeve të Punës në Sekretariatit e KGJK-së;
  - Rregullore për organizimin e brendshëm në gjykata;
  - Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit;
  - Rregullore për transferimin dhe avancimin e prokurorëve;

- Rregullores për punës së Komisionit Disiplinor dhe procedurën disiplinore ndaj prokurorëve;
- Aktit nënligjor që rregullon zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor;
- UA që përcakton kushtet dhe procedurat e veçanta për dhënien e lejes për të dënuarit që punojnë jashtë institucionit korrektues, dhe procedurat për punën e të dënuarve jashtë institucionit korrektues;
- UA për mbrojtjen e fëmijëve në internet;
- Rregullores për përkrahjen e projekteve për komunitete;
- Miratimi i dokumenteve të politikave:
  - Planit Strategjik të Sistemit Prokurorial 2019 – 2021;
  - Strategjisë dhe PV për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (2018-2022);
  - Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2018-2022;
  - Strategjisë për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
  - Strategjisë dhe PV për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2022;
  - Strategjisë për Komunitete dhe Kthim;
  - Strategjisë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve;
  - Koncept-dokumentit për iniciimin dhe themelimin e Byrosë shtetërore për përkthime;
  - Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (2017-2020);
- Përzgjedhja e tre (3) anëtarëve/eve të Këshilli Prokurorial të Kosovës;
- Rekrutimi i 9 prokurorëve dhe 32 gjyqtarëve të rinj;
- Transferimi i tetë (8) prokurorëve në PSRK;
- Funkcionalizimi i Programit për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Lëndëve;
- Funkcionalizimi i regjistrit të centralizuar të evidencës penale;
- Themelimi i qendrës diagnostikuese për klasifikimin e personave të burgosur;
- Emërimi i zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi në nivelin lokal;
- Krijimi i bazës së të dhënave për personat e zhvendosur;
- Emërimi i komisionerit dhe anëtarëve të Bordit të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Kryerja e 37 inspektimeve për noterë dhe 38 inspektimeve për përmbarues privatë;
- Shqiptimi i gjobave ndaj subjekteve politike lidhur me mospublikimin e raportit të shpenzimeve vjetore dhe të fushatës zgjedhore;
- Hartimi i raporteve monitoruese për zbatimin e Strategjisë kundër korrupsionit;
- Publikimi i Indeksit të Barazisë Gjinore 2018;
- Krijimi i mekanizmave për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve me dhunti të veçanta/inteligjencë të jashtëzakonshme dhe talente në fusha akademike;
- Zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor nga institucionet e Kosovës;
- Zbatimi i 35 vendimeve të pazbatuara për rrënimin e strukturave ilegale të ndërtuara në prona private;
- Mbyllja e 5 qendrave kolektive në komunën e Shtërpçës;
- Kryerja e inspektimeve të rregullta dhe inspektime bazuar në ankesa mbi zbatimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale;


*Si rrjedhojë e të gjeturave të raportit, edhe pse ka një nivel të lartë të zbatimit rreth 67%, ky sektor përgjithësisht ka pasur vonesa në miratimin e ligjeve dhe akteve nënligjore. Shumica e akteve nënligjore nuk janë miratuar në kohë për shkak të vonesave në miratimin e Ligjit për Gjykatat, Ligjit për KPK dhe Ligjit për Prokurorin e shtetit në Kuvend. Në anën tjetër ka masa të cilat kanë qenë të parapara në vitin 2018 mirëpo kanë arritur të miratohen vetëm në Janar të vitit 2019 rrjedhimisht janë konsideruar si të papërfunduara si: Rekrutimi i 32 gjyqtarëve, miratimi i UA për mbrojtjen e fëmijëve në internet apo Strategjia për mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu vonesat në miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave Personale në Kuvend kanë reflektuar në vonesa në zbatimin e masave të parapara në këtë fushë brenda viti 2019. Shqetësuese vazhdon të mbetet mos miratimi brenda afatit të paraparë si dhe vonesat në miratim të Strategjive në fushën e të drejtave themelore, të cilat janë bartur në vitin 2019.*



### 3.24. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria

Ky kapitull përmban 107 masa: 10 masa legjislative (9.34%) dhe 97 masa zbatuese (90.66%).

Diagrami 3.24. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Drejtësia, liria dhe siguria



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecuresisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 77.57%*, pasi që **83 nga 107 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 22.43% e tyre (24 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat kyçe që *nuk kanë arritur të zbatohen* janë:

- Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për drejtësi, liri dhe siguri:
  - Marrëveshjes me Malin e Zi për ekstradim;
  - Marrëveshjes me Malin e Zi për ekzekutim të ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në çështjet penale;
  - Marrëveshjes me Malin e Zi për ndihmë juridike të ndërsjellë në çështjet Penale; dhe
  - Marrëveshjes me Italinë për transferim të personave të dënuar mes dy vendeve;
- Miratimi i akteve nënligjore për drejtësi, liri dhe siguri:
  - UA për procedurën standarde të pritjes dhe trajtimit fillestar të azilkërkuesve;
  - UA për Procedurat dhe Standardet e Shqyrtimit dhe Marrjes së Vendimit Lidhur me Kërkesën për Azil;
  - UA për Procedurën e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt dhe vërtetimit për lajmërimin e punës;
  - Rregullores për integrimin e të huajve;
  - UA për kthimin e të huajve; rregullores punës dhe e procedurave të Autoritetit Qeveritar për Migrim;
- Miratimi i dokumenteve të politikave në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë:
  - Strategjisë së re shtetërore dhe PV për MIK 2019-2024;
  - Planit të reagimit për menaxhimin e fluksit të mundshëm me migrantë;
  - Strategjisë së re shtetërore dhe PV për migrim 2019-2024;
  - Planeve komunale të riintegrit;
  - Strategjisë për policimin e udhëhequr nga inteligjenca;
  - Strategjisë shtetërore dhe PV kundër krimit të organizuar 2018 - 2023;
- Ngritja kapaciteteve institucionale në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë:
  - Katër (4) trajnime të specializuara për identifikimin e dokumenteve të falsifikuara (për 30 zyrtarë);
  - Avancimi i pajisjeve në fushën e teknologjisë informative;
  - Ndërtimi i stacionit policor për toqjet patrulluese kufitare në Vitomiricë;
  - Funkcionalizimi i pikës së kalimit kufitar në Kapi;
  - Fillimi i ndërtimit të pikë-kalimit të përbashkët për kontroll kufitar ne Bernjak dhe Stanqiq-Bellanoc;
  - Ndërtimi i pikë-kalimeve të përbashkëta te kontrollit kufitar ne Merdare dhe Mutivodë;


Si rrjedhojë e të gjeturave të raportit, edhe pse ka një nivel të lartë të zbatimit rreth 77,57%, ky sektor përgjithësisht ka pasur vonesa në miratimin e akteve nënligjore: Plotësim-ndryshimi i UA nr. 16/2013 për Procedurën Standarde të Pritjes dhe Trajtimin Fillestare të azilkërkuësve; (Plotësim-ndryshimi i UA për Procedurat dhe Standardet e Shqyrtimit dhe Marrjes së Vendimit Lidhur me Kërkesën për Azil; Plotësim-ndryshimi I UA për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të huajt dhe Vërtetimit për lajmërimin e punës; Në anën tjetër, një numër i dokumenteve strategjike të cilat kanë qenë të parapara të miratohen në vitin 2018 nuk janë përbushur gjatë afatit të paraparë: Miratimi i Strategjisë së re shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2019-2024; Miratimi i Strategjisë për policimin e udhëhequr nga inteligjenca; Miratimi i Strategjisë shtetërore dhe plani i veprimit kundër Krimit të organizuar 2018-2023; Miratimi i strategjisë së re shtetërore dhe plani i veprimit për MIK 2019-2024. Për më tepër, 4 marrëveshje për bashkëpunim juridik të cilat do të duheshin të nënshkruhen gjatë vitit 2018 janë bartur si masa për vitin 2019; Nënshkrimi i Marrëveshjes për Ekstradim mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi; Nënshkrimi i Marrëveshjes për Ekzekutim të Ndërsjellë të Vendimeve gjyqësore në Çështjet Penale mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi; Nënshkrimi i Marrëveshjes për Ndihmë Juridike të Ndërsjellë në Çështjet Penale mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi; Nënshkrimi i Marrëveshjes për Transferim të Personave të Dënuar mes Republikës së Kosovës dhe Italisë.

### 3.25. Kapitulli 25 i acquis-së: Shkenca dhe kërkimet shkencore

Ky kapitull përmban 2 masa: 1 masë legislative (50%) dhe 1 masë zbatuese (50%).

Diagrami 3.25. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Shkenca dhe kërkimet shkencore

3.26. Kapitulli 25 i acquis-së: Shkenca dhe hulumtimet (masa: 2)



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 100%**, pasi që **2 nga 2 masat** e planifikuara janë zbatuar plotësisht.


Ky sektor ka nivel shumë të kënaqshëm pasi që të gjitha masat e planifikuara gjatë vitit 2018 janë zbatuar.

### 3.26. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura

Ky kapitull përmban 5 masa: 2 masa legislative (40%) dhe 3 masa zbatuese (60%).

Diagrami 3.26. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Arsimi dhe kultura

3.27. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura (masa: 5)



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 20%**, pasi që **1 nga 5 masat** e planifikuara është zbatuar, ndërsa 80% e tyre (4 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat kyçe që **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:

- Miratimi i UA për kushtet dhe kriteret që drejton themelimin e formave duale të arsimit dhe aftësimin profesional në të cilën aftësimi paraprak dhe përvoja realizohen në ndërmarrje;
- Zhvillimi i kurrikulës për edukim parashkollor (mosha 0-5 vjeç) në 7 institucione parashkollore;
- Ndërtimi i tetë (8) Institucioneve parashkollore publike.

*Ky sektor përgjithësisht është përballur me vonesa serioze pasi që shumica e masave të planifikuara nuk janë realizuar.*

### 3.27. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi

Ky kapitull përmban 21 masa: 10 masa legislative (47.62%) dhe 11 masa zbatuese (52.38%).

Diagrami 3.27. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Mjedisi



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 47.62%**, pasi që **10 nga 21 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 52.38% e tyre (11 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat kyçe që **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:


- Miratimi i tri projektligjeve:
  - Ligji për mbeturinat nga industria e nxjerrjes së mineraleve;
  - Ligji për gjuetinë; dhe
  - Ligji për pyjet e Kosovës;
- Miratimi i dy akteve nënligjore:
  - UA për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
  - UA për eksport, import dhe transit të mbeturinave;
- Miratimi i dy dokumenteve të politikave:
  - Strategjisë për menaxhimin e mbeturinave 2018-2028 dhe PV 2018 – 2020; dhe
  - Strategjisë dhe PV për ndryshime klimatike.

*Bazuar në të dhënat e ofruara më lart, rezulton se zbatimi i masave në kuadër të këtij kapitulli nuk është në nivelin e kënaqshëm. Pavarësisht realizimit të një numri të madh të masave ligjore dhe zbatuese, disa nga masat kyçe të planifikuara për këtë kapitull, përkatësisht aktet ligjore dhe nënligjore si dhe nga korniza e politikave të cilat ndikojnë në reformimin e politikave të sektorit të mjedisit, kanë dështuar të miratohen dhe realizohen sipas afateve të parapara. Për më tepër, disa prej këtyre masave përcillen si të parealizuara nga viti paraprak, siç është rasti i Strategjisë për Ndryshime Klimatike, miratimi i Ligjit për gjuetinë si dhe Ligjit për pyjet e Kosovës.*

### 3.28. Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

Ky kapitull përmban 17 masa: 9 masa legjislative (52.94%) dhe 8 masa zbatuese (47.05%).

Diagrami 3.28. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 29.41%**, pasi që 5 nga 17 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 70.59% e tyre (12 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat kyçe që **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:


- Miratimi i dy projektligjeve:
  - Ligji për shëndetësi dhe
  - Ligji për sigurime shëndetësore;
- UA për rregullimin e çmimit të produkteve dhe pajisjeve medicinale.

Ky sektor përgjithësisht përballlet me vonesa serioze pasi që 70% e masave nuk kanë arritur të realizohen.

### 3.29. Kapitulli 29 i acquis-së: Unioni Doganor

Ky kapitull përmban 5 masa: 1 masë legjislative (20%) dhe 4 masa zbatuese (80%).

Diagrami 3.29. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Unioni doganor



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 80%**, pasi që 4 nga 5 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 20% e tyre (1 masë legjislative) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masa që **nuk ka arritur të zbatohet** është miratimi i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës.

Ky sektor përgjithësisht ka nivel të kënaqshëm të zbatimit pasi që 80% e masave të planifikuara janë realizuar, ndërsa masa e pazbatuar lidhur me plotësim ndryshimin e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës është bartur në programin legjislativ të vitit 2019.

### 3.30. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë

Ky kapitull nuk përmban masa afatshkurtra.

### 3.31. Kapitulli 31 i acquis-së: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes

Ky kapitull përmban 4 masa, 1 masë legislative (25%) dhe 3 masa zbatuese (75%).

Diagrami 3.31. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecures, të prezantuara në diagramin më sipër, **niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 25%**, pasi që **1 nga 4 masat** e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 75% e tyre (3 masa) nuk kanë arritur të zbatohen.

Masat që **nuk kanë arritur të zbatohen** janë:


- Miratimi i projektligjit për sanksione ndërkombëtare;
- Miratimi i Strategjisë për politikën e jashtme dhe
- Miratimi i Strategjisë kombëtare e sigurisë.

*Si rrjedhojë e të gjeturave të raportit, ky sektor përgjithësisht ka vonesa serioze në masat e planifikuara. Duhet të theksohet se vonesat e rëndësishme shfaqen në miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë dhe në plotësim-ndryshimin e Ligjit për Sanksione Ndërkombëtare. Për shkak se ky i fundit me rekomandim të Këshillit të Evropës do të plotësohet në mënyrë që të mbulojë edhe fushën e sanksioneve financiare të shenjëstruara ndërkombëtare, pra në formë të lex speicalis, përfundimi i këtij veprimi është shtyrë për tremujorin e parë të vitit 2019. Po ashtu, masat tjera të këtij kapitulli që janë planifikuar të përfundohen në fillim të vitit 2019 siç janë miratimi i Planit të Veprimit për Zhvillim sa më efikas të Dialogut Politik në mes të RKS-së dhe BE-ë si dhe miratimi i Strategjisë për Punë të Jashtme kanë vonesa në zbatim dhe janë bartur për zbatim në fillim të vitit 2019.*

### 3.32. Kapitulli 32 i acquis-së: Kontrolli financiar

Ky kapitull përmban 11 masa zbatuese.

Diagrami 3.32. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2018: Kontrolli financiar



Bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, të prezantuara në diagramin më sipër, *niveli i zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2018 është 100%*, pasi që 11 nga 11 masat e planifikuara janë zbatuar plotësisht.

*Si rrjedhojë e të gjeturave të raportit, masat në këtë sektor janë zbatuar në tërësi.*

### **3.33. Kapitulli 33 i acquis-së: Dispozitat financiare dhe buxhetore**

Ky kapitull nuk përmban masa afatshkurtra.